

L I G J
Nr.8779, datë 26.4.2001

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, NDRYSHUAR ME LIGJET NR.8070, DATË 15.2.1996; NR.8126, DATË 9.7.1996; NR.8130, DATË 22.7.1996; NR.8149, DATË 11.9.1996; NR.8160, DATË 7.11.1996; NR.8166, DATË 23.1.1997; NR.8201, DATË 20.3.1997; NR.8140, DATË 16.9.1997; NR.8445, DATË 21.1.1999 DHE NR.8714, DATË 15.12.2000

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995, ndryshuar me ligjet nr.8070, datë 15.2.1996; nr.8126, datë 9.7.1996; nr.8130, datë 22.7.1996; nr.8149, datë 11.9.1996; nr.8160, datë 7.11.1996; nr.8166, datë 23.1.1997; nr.8201, datë 20.3.1997; nr.8140, datë 16.9.1997; nr.8445, datë 21.1.1999 dhe nr.8714, datë 15.12.2000, pas nenit 25/3 shtohet neni 25/4 me këtë përmbajtje:

“Neni 25/4

Përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar shitja e gazetave dhe e revistave ditore e javore, si dhe shërbimi i reklamave që ato publikojnë për persona të tjerë.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.3006, datë 10.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Rexhep Meidani